



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 68, datë 11.11.2025



PËR MIRATIMIN E KALIMIT NË ADMINISTRIM TË VARREZAVE, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE RRASHBULL, SUKTH, KATUNDI I RI, MANËZ DHE ISHËM, TEK NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr. 510, datë 10.6.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, VKM-në nr.295, datë 2.5.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të ish komunës Ishëm”, VKM-në nr.538, datë 7.8.2012 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut Durrës”, VKM-në nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-në nr. 431, datë 15.05.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Katundi i Ri, të Qarkut të Durrësit”, VKM-në nr. 1003, datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës të varrezave dhe shërbimin funeral për fshatrat e njësive administrative të Bashkisë Durrës, sipas listës së përcaktuar në Aneksin nr. 1, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të Këshillit Bashkiak.
3. Ngarkimin e Njësive Administrative përkatëse, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Sektorin e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve që, brenda një afati prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të dorëzojnë pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale dokumentacionin, inventarët dhe çdo të dhënë lidhur me varrezat e territorit të tyre.
4. Ngarkimin e Drejtorisë Ekonomike dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës që bazuar në Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, për pasqyrimin në kontabilitet të vlerës së pasurisë dhe kalimin e saj në inventarin ekonomik sipas legjislacionit financiar të varrezave të pasqyruara në Aneksin 1.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës


Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 12.11.2025

**Lista e varrezave që kalohen në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale
Durrës**

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Ishëm	Ishëm				
2	Ishëm	Likmetaj	185	2453		
3	Ishëm	Kërtushaj	304-169-24/5-230, 26-68-87	2147		
4	Ishëm	Kapidanaj	46-68-87	2078		
5	Ishëm	Gjuricaj	140	1771		
6	Ishëm	Lalëz	49-108-247	2375		
7	Ishëm	Kuraten	126	2332		
8	Ishëm	Bizë	178-193	1204		
9	Ishëm	Draç	102-86-115-129/3	1522		
10	Ishëm	Shetaj	200-234	3365		




NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Rrashbull	Rrashbull	83/3. 108, 118/1, 188	3215		
2	Rrashbull	Arapaj	59/2, 308, 59/1, 103, 104/1, 118/1	1031		
3	Rrashbull	Shenvlash	192	3339		
4	Rrashbull	Shkallinur	165/6, 166, 167, 162/30	3385		
5	Rrashbull	Maskuri	91	2591		
6	Rrashbull	Bozaxhie	334/2, 794, 546/7	1256		
7	Rrashbull	Romanat	238/1, 238/2, 54/2, 163, 159/3, 318/13, 318/14	3236		
8	Rrashbull	Xhafzotaj	166, 167	2574		

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Katundi I Ri	Sukth-Erzen	179			
2	Katundi I Ri	Sukth-Erzen	136			
3	Katundi I Ri	Katundi i Ri	117			
4	Katundi I Ri	Jubë	96			
5	Katundi I Ri	Qerret	87			

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Sukth	Sukth	56	3542		
2	Sukth	Hamallaj		1925		
3	Sukth	Kullë		2321		
4	Sukth	Perlat	10, 11, 26	2321		
5	Sukth	Vadardhë		3690		
6	Sukth	Rrushkull		3241		
7	Sukth	Hidrovor		1925		


NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Manëz	Manëz	66/22, 67	2590		
2	Manëz	Fshat Manëz	237/6, 244	2590		
3	Manëz	Armath	75, 78/2	1038		
4	Manëz	Borç	8	1243		
5	Manëz	Hamallaj				
6	Manëz	Kameras	75	2065		
7	Manëz	Shkallë	38	3383		
8	Manëz	Varrezat e katolikëve Shkallë	82/16	3383		
9	Manëz	Radë	61	3137		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 798/prot.
7



Durrës, më 14 . 11 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.68 datë 11.11.2025 ,” Për miratimin e kalimit në administrim të varrezave, të njësive administrative Rrashbull, Sukth, Katundi i ri, Manëz dhe Ishëm, tek Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

